

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Obiliqi – Raporti komunal

Nëntor 2009

Obiliqi në shifra

Popullsia	Gjithsej	27771
	Shqiptarë	90%
	Serbë	6%
	Të tjerë	4%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	105
	Numri i fshatrave	19
Shkollimi	Pa shkollë/ filllore e papërfunduar	11%
	Filllore/e mesme e papërfunduar	33.01%
	E mesme	50.16%
	Shkollë e lartë	5.18%
	Universitet	0.65%
	Nr. i nxënësve	5,049
	Nr. i mësimdhënësve	305
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	2
	Nr. i shkollave filllore (me paralele të ndara)	17
	Nr. i çerdheve	1
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		7
Nr. i mjekëve		33
Papunësia	Gjithsej	58.23%
	Meshkuj	48.55%
	Femra	79.87%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	16,940
	Të punësuar në sektorin publik komunal	629
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	3,135,493
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	430,000
	Të hyrat tjera (Euro)	2,705,493
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	2,561,506 (84%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	517,187 (57%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	2,044,319 (95%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	32.88%
	LDK	29.16%
	AKR	16.11%
	AAK	12.64%
	PD	3.96%
	ORA	2.55%
	Tjera	2.51%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Rexhep Kelani (LDK) 2002-2007: Ismet Hashani (LDK) 2007-2009: Rexhep Kelani (LDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Obiliqin

Obiliqi si territor në vete daton që nga koha e perandorisë turke, kurse si komunë daton që nga viti 1989. Që nga viti 2009, qyteti i Obiliqit njihet edhe me emrin Kastriot. Kjo komunë shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshinë një territor prej 105 km². Bashkë me 19 fshatra, Obiliqi ka një popullatë prej 27,771 banorë. Popullatën e kësaj komune përveç shqiptarëve (90%) e përbëjnë edhe komunitete tjera si serb, romë, shkali (10%). Ekonomikisht Obiliqi ka një rëndësi të veçantë për Kosovën. Kjo komunë është ndër qendrat më të mëdha industriale në Kosovë, falë rezervave të mëdha të thëngjillit dhe termocentraleve Kosova A dhe Kosova B. Por, pikërisht këta dy gjigant të energjisë shkaktojnë edhe një ndër problemet më madhore që ka kjo komunë, ndotjen e ajrit. Niveli i ndotjes së ajrit në këtë komunë i kalon të gjitha parametrat e lejueshmërisë, duke bërë që shumë familje edhe të largohen përfundimisht nga kjo komunë.

Problemet aktuale

Qytetarët e Komunës së Obiliqit tash e sa kohë përballen me nivelin e lartë të ndotjes së ambientit që shkaktohet nga KEK. Uji i pijes është problem tjetër që kërkon zgjidhje në këtë komunë. Ndër problemet tjera me të cilat ballafaqohen qytetarët e kësaj komune janë edhe:

- Ajri i ndotur
- Uji i pijes
- Shëndetësia
- Vendbanimet jo të qëndrueshme
- Arsimi

Problemi më i madh me të cilin po përballen qytetarët e Komunës së Obiliqit është **ndotja e ambientit**. Si pasojë e punës së dy termocentraleve, Kosova A dhe Kosova B, jo vetëm komuna e Obiliqit, por edhe ajo e Fushë Kosovës dhe Prishtinës vuajnë pasojat e ajrit të ndotur që lëshohet nga termocentralet. Qyteti i Obiliqit ndodhen në mes të dy termocentraleve. Kosova A është termocentral më i vjetër dhe shkakton ndotje më të madhe se sa Kosova B. Qymyri që përdoret për prodhimin e rrymës njihet si qymyr i cilësisë së dobët i cili liron shumë gazra me erë të rëndë dhe të dëmshëm për shëndetin. Përveç tymit të termoelektranave, ndotja vjen edhe nga hiri i qymyrit, hi i cili është aq i madh në sasi sa që nga ai janë krijuar kodrina që duken si kodrina natyrale. Kjo komunë edhe pse ofron shërbime për KEK-un dhe rrezikon shëndetin e banorëve të saj, nuk ka përfitime nga ana e KEK-ut. Si pasojë e pranisë së KEK-ut kjo komunë ka një numër të madh të banorëve të sëmurë kryesisht nga sëmundjet e mushkërive (frymëmarrjes), edhe pse nuk dihet saktësisht numri i të sëmurëve. Përpos që KEK-u shkakton dëme në ambient (ndotë lumenjtë e vegjël të komunës), shkakton sëmundje tek banorët, ajo nuk ndihmon në uljen e papunësisë. Numri i të punësuarve në KEK nga komuna e Obiliqit është shumë simbolik. Disa nga fshatrat e Obiliqit madje kanë edhe mungesë të energjisë elektrike. Qytetarët kanë kërkuar nga komuna të bëjë më shumë presion në KEK apo edhe Qeveri, të kërkoj kompensime të ndryshme, qoftë lirime nga ngarkesat e ndryshme, apo edhe kushtëzimit me punësim, por gjerë më sot asgjë konkrete nuk është ndërmarrë.

Uji i pijes. Sa i përket ujit të pijes, Obiliqi ka dy probleme: pamjaftueshmëria e ujit të pijes dhe kualiteti i dobët i tij. Pjesa më e madhe e Komunës së Obiliqit furnizohet me ujë nga Liqeni i Batllavës dhe menaxhohet nga kompania e ujësjellësit rajonal "Prishtina". Pasi që vetë Prishtina ka probleme me furnizim me ujë, edhe Obiliqi dhe Fushë-Kosova kanë të njëjtin problem. Në këto dy komuna edhe reduktimet janë më të mëdha. Problemi i dytë sa i përket ujit të pijes është kualiteti i tij. Banorët që përdorin ujin nga burimet e ujit në territorin e Obiliqit, vuajnë nga kualiteti i ujit pasi që uji është i përzier me fenol. Përçindja e madhe e gëlqeres që gjendet në ujin e pijes, shkakton probleme shëndetësore tek qytetarët, si dhe prish mjetet e amvisërisë. Mjetet e amvisërisë dhe në përgjithësi teknika e bardhë që shfrytëzon këtë ujë, siç janë makina për larjen e enëve, larjen e rrobave, ngrohësi i ujit, prishen shumë shpejt pasi dëmtohen nga gëlqerja e cila forcohet dhe formon një shtresë të gurit.

Shëndetësia. Në kuadër të komunës së Obiliqit funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe shtatë punkte shëndetësore nëpër fshatra. E tërë komuna e Obiliqit me 19 fshatra shërbehet vetëm me një autoambulancë. Në rast se ndodhin dy raste emergjente në të njëjtën kohë, punonjësit në QKMF duhet të vendosin se cilit rast do t'i përgjigjen me autoambulancën e vetme në dispozicion. Mungesa e autoambulancës nuk është i vetmi problem. As aparaturat tjera të nevojshme nuk gjendet në shëndetësinë primare të Obiliqit. Gjatë qeverisjes aktuale janë funksionalizuar disa pajisje të cilat kanë qenë donacione nga organizatat e huaja dhe me vite të tërë kanë qenë jo funksionale. Në dy vitet e fundit nuk është bërë asnjë investim në shëndetësinë primare në Obiliq. Ashtu sikur Vitia që ka një problem me sëmundjet e veshkave si pasojë e kualitetit të ujit të pijes, Obiliqi ka një problem tjetër, sëmundjet e frymëmarrjes si pasojë e ajrit të ndotur. Edhe përkundër këtij problemi, në Komunën e Obiliqit nuk ka asnjë pulmolog (specialist për sëmundjet e frymëmarrjes). Po ashtu nuk ka as onkolog, as internist, as biokimist. Për të gjitha këto sëmundje qytetarët e kësaj komune duhet të drejtohen në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Edhe pse QKUK është institucion shëndetësor i nivelit terciar, në mungesë të një spitali regjional në Prishtinë, ashtu si në regionet tjera, QKUK kryen edhe shërbimet e nivelit sekondar mjekësor. Kjo ndikon që QKUK të jetë shumë e ngarkuar me pacientë dhe paraqet problem të dyanshëm, si për qytetarët që kanë në nevojë për shërbimet e këtij institucioni ashtu edhe për menaxhmentin e QKUK i cili nuk mund t'iu përgjigjet të gjitha kërkesave për ndihmë. Andaj funksionalizimi i këtyre shërbimeve në Obiliq do të lehtësonte sadopak punët qytetarëve të cilët kanë nevojë për këto mjekime.

Vendbanimet jo të qëndrueshme pasi që e tërë komuna është futur në "zonë të interesit të veçantë ekonomik." Kosova ka përfituar shumë ekonomikisht duke shfrytëzuar pasuritë nëntokësore, e më së shumti duke shfrytëzuar qymyrin për prodhim të rrymës dhe ngrohje. Rezervat e mëdha të qymyrit, ka bërë që dikur Kosova të shes rrymë edhe në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë dhe më gjerë. Edhe pse banorët e Obiliqit jetojnë mbi këto pasuri nëntokësore, ata nuk kanë përfituar shumë nga ky fakt. Përkundrazi janë dëmtuar. Problemi numër një që cekëm më lartë është ambienti i ndotur. Problemi tjetër me të cilin përballlet tërë territori i komunës, është edhe mos qëndrueshmëria e vendbanimeve të tyre. Me këtë nënkuptohet fakti se e tërë zona e Obiliqit, e edhe më gjerë, është shpallur zonë e interesit të veçantë ekonomik. Në vitin 2004 me vendimin 04/119, Qeveria e Kosovës kishte shpallur zonë të interesit të veçantë ekonomik hapësirën ku është vendosur fshati Hade. Sipas këtij vendimi, banorët e kësaj lagjeje duhej të zhvendoseshin gradualisht nga fshati dhe të vendosen në pjesët e tjera të Obiliqit, apo edhe në

Prishtinë. Kanë kaluar gati pesë vjet dhe ky proces nuk është përmbyllur. Banorët e Hades nuk e kanë marrë dëmshpërblimin e premtuar nga Qeveria. Tani së fundi ka rifilluar sërish shpronësimi në disa lagje të këtij fshati. Por, vendimi i Qeverisë së Kosovës në mars të këtij viti, vendimi 02/57, shpall zonë të interesit të veçantë ekonomik “Fushën e Mihjes së Re”. Fusha e Mihjes së Re, përveç Hades, përfshinë edhe 20 zona të reja kadastrale. Nga komuna e Obiliqit, në zonën e interesit të veçantë ekonomik përfshihen 12 zona kadastrale: Dardhishtë, Kastriot, Palaj, Hade, Shipitullë, Sibovc, Zhilivodë, Lajthishtë, Plemetin, Hamidi, Milloshevë, dhe Mazgit. Nga komuna e Fushë Kosovës përfshihen 6 zona kadastrale: Bardh i Madh, Greboc i Poshtëm, Fushë Kosovë, Kuzmin, Pomazatin dhe Mirash. Nga Komuna e Vushtrrisë përfshihen 3 zona kadastrale: Bivolak, Glavotinë dhe Priluzhë. Kurse nga komuna e Drenasit përfshihet vetëm zona kadastrale e Vasiljevës. Shfrytëzimi i “Fushës së Mihjes së Re” do të bëhet në një proces afatgjatë në 4 apo 5 dekadat e ardhshme. Shfrytëzimi do të fillohet pas ndërtimit të termocentralit të ri “Kosova e Re”, proces i cili do të zgjatë disa vite. Por banorët e këtyre lokaliteteve nuk janë të sigurt që të investojnë në këtë pjesë, ngase në një të ardhme jo të afërt atyre do ju duhet të largohen dhe të shpërngulen sikurse banorët e Hades. Nëse dëshirojnë të shpërngulen tani, ata nuk do të mbështeten nga Qeveria, nëse vendosin të rrinë në tokat e tyre, ata nuk mund të llogarisin në një investim afatgjatë. Edhe pse komuna ka pak të bëjë me këtë problem, në investimet kapitale të ardhshme komuna duhet të mendojë edhe për këtë, ngase një investim i komunës në një zonë me interes të veçantë ekonomik mund të jetë investim i kotë.

Në testin kombëtar të maturës 2008, maturantët e Obiliqit kanë shfaqur performancën më të dobët në Kosovë, ku vetëm 9.2% e maturantëve kanë kaluar testin e parë kurse në të dytin kanë kaluar vetëm 5.6%. Kjo dëshmon se **arsimi** është në gjendje të mjerueshme në këtë komunë. Nxënësit e shkollës së mesme profesionale nuk mbajnë fare orë praktike dhe kjo shihet si pengesë e madhe në kalimin e testit të maturës. Kurse arsye tjetër për dështim të maturantëve në testin e maturës merret edhe fakti se shumica e shkollave të Obiliqit deri tani kanë zhvilluar mësimet e tyre në kontejner. Sa i përket infrastrukturës shkollore, infrastruktura është përmirësuar dukshëm pas ndërtimit të objekteve të reja shkollore. Edhe pse këtë vit testi i kalueshmërisë së maturës nga të dyja afatet është 50%, sërish, niveli i edukimit mbetet i dobët. Në nivelin e ulët të edukimit ndikon edhe mungesa e transportit publik, meqë autobusët janë të pakontrolluar, me orar jo të rregullt, dhe banorët e vendeve rurale tentojnë të mos i dërgojnë fëmijët për shkollim të mëtutjeshëm në Obiliq, si shkak i pasigurisë së udhëtimit, si dhe kushteve të rënda ekonomike.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në zgjedhjet e vitit 2007, partitë që morën më së shumti vota ishin LDK dhe PDK. Në raundin e parë LDK kishte marrë 31.8% të votave kurse PDK 30.6%. Ndërkaq në zgjedhjet e balotazhit LDK, e kryesuar nga Rexhep Kelani kishte fituar 51.5% përball kandidatit nga PDK, Haki Mjeku. Kësisoj Rexhep Kelani siguroi një mandat dy vjeçar me komunën e Obiliqit.

Shumë nga premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore 2007 nga ana e LDK nuk janë realizuar. Megjithatë ka pas disa përjashtime. Një nga premtimet më madhore ka qenë ndërtimi i katër shkollave fillore. Dy shkolla janë ndërtuar në Milloshevë dhe

Plemetin, një tjetër në Obiliqin e vjetër, por në fshatin Babimost nuk është realizuar akoma. Për përmirësimin e ambientit, kishte premtime se do të mbillen fidane dhe drunj. Një iniciativë e tillë edhe është marrë, por nuk ka pasur rezultate afatgjate ngase fidanet nuk janë mirëmbajtur dhe kësaj janë vyshkur shpejt. Premtim tjetër me rëndësi ka qenë se komuna do të kthejë borxhin (rreth 4 milion euro) që KEK i ka komunës së Obiliqit. Një premtim i tillë nuk është quar deri në fund. Njëjtë ka ndodhur edhe me premtimin për ndërtimin e shtëpisë së kulturës. Obiliqi vazhdon të mos ketë shtëpi të kulturës. Kurse sa i përket premtimit se kjo qeverisje lokale do ta luftoj familjarizmin dhe korrupsionin në komunë, qytetarët vlerësojnë se nuk ka pasur ndonjë angazhim serioz për këtë. Raste të nepotizmit vazhdojnë të jenë dukuri e zakonshme në këtë komunë. Tabela e më poshtme ofron më shumë detaje rreth premtimeve dhe realizueshmërisë së tyre.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Ndërtimi i katër shkollave fillore	Dy shkolla fillore janë ndërtuar plotësisht (në Milloshevë dhe në Plemetin), ndërsa shkolla tjetër fillore që gjenden në Obiliqin e vjetër është në ndërtim e sipër. Ndërsa shkolla tjetër që do të duhej të bëhej në fshatin Babimost nuk është realizuar për shkak të pengesave që bashkësia serbe ka vënë.
Ndërtimi i shtëpisë së kulturës	Ky premtim nuk është realizuar
Inkasimi i borxheve të KEK-ut që kjo korporatë ja ka borxh komunës (rreth 4 milion €)	Ky premtim nuk është pëmbushur
Do të mbillen fidane dhe drunj të cilët do të shërbejnë si filtra për pastrim të ambientit	Edhe pse ka pasur disa iniciativa për mbjelljen e fidaneve dhe drunjve, sidomos me mbështetje organizatave si "Aureola" dhe Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit, rezultatet janë të pakta. Kjo për faktin se fidanet e pakta që janë mbledhur janë vyshkur menjëherë pasi që nuk janë mirëmbajtur. Ky premtim nuk është pëmbushur.
Do të llobohet që të ndërtohet termocentrali Kosova C, me qëllim që termocentrali Kosova A të të pushojë së funksionuari.	Kosova C do të ndërtohet në bazë të vendimit të Qeverisë të marrë në korrik 2009, kurse Kosova A do të rrenohet pas ndërtimit të Kosovës C.
Do të luftohet familjarizmi në komunë si dhe korrupsion.	Komuna nuk është angazhuar në luftimin e familjarizmit dhe korrupsionit. Premtim i pa realizuar.

Zgjedhjet lokale në Obiliq

Që nga viti 2000 Komuna e Obiliqit është qeverisur nga LDK përmes dy kryetarëve të ndryshëm. Në zgjedhjet e para të vitit 2000, LDK kishte arritur të sigurojë numrin më të madh të ulëseve në KK. Nga 21 ulëse, LDK kishte siguruar 12, PDK 5 dhe AAK 4. Në zgjedhjet e dyta, ato të vitit 2002, LDK kishte arritur përsëri të marrë qeverisjen e komunës duke kryesuar bindshëm ndaj partive tjera. Edhe kësaj here LDK-së i kishte takuar numri më i madh i ulëseve, 11 sosh, kurse PDK kishte marrë 6. Katër ulëset e

mbetura ishin ndarë mes PD, Povratak, PKM dhe OSPS. Zgjedhjet e fundit, ato të vitit 2007 sollën një ndarje tjetër të ulëseve të KK. Kësaj radhe PDK kishte siguruar 7 ulëse në KK, apo numrin më të madh të ulëseve. LDK edhe përkundër faktit se lideri i saj kishte fituar të drejtët të qeverisë me komunën, kishte marrë 6 ulëse në KK, ndërsa AAK dhe AKR nga 3 ulëse dhe 2 ulëse të mbetura ishin ndarë mes ORA dhe PD.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Obiliqit.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	1691	5	2150	6	2086	7
LDK	4370	12	4026	11	1850	6
AAK	1246	4	-	-	802	3
ORA	-	-	-	-	162	1
AKR	-	-	-	-	1022	3
PD	-	-	217	1	251	1
“Povratak”	-	-	265	1	-	-
PKM	-	-	287	1	-	-
OSPS	-	-	249	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte e kënaqshme me 82.5%, në zgjedhjet e vitit 2002 ra në 44.2%. Ndërkaq, në zgjedhjet e vitit 2007 numri i votuesve ra edhe më shumë në 40.3%. Në përgjithësi në komunat e Kosovës përderisa numri i qytetarëve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, numri i pjesëmarrësve në votime ka shkuar duke rënë. Kjo lë dyshimin se edhe në zgjedhjet e Nëntorit 2009 numri i votuesve do të jetë edhe më i vogël. Të drejtë vote në këtë komunë kanë 20,155 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Obiliq në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	9737	17569	15720	20155
Pjesëmarrja në votime	8033	7774	6345	-
Përqindja e daljes në votime	82.5%	44.25%	40.3%	-

Buxheti i Komunës

Komuna e Obiliqit nuk ka ndonjë buxhet të madh vjetor. Në fakt, buxhetin më të lartë kjo komunë e ka pasur në vitin 2009, gjithsej 3,135,494 euro, që krahasuar me vitin 2008 ishte për 778,790 euro më i lartë. Ndërkaq prej vitit në vit buxheti i komunës ka shkuar duke u rritur, përveç në vitet 2006-2007 ku është zvogëluar. Në vitin 2009 bashkë me rritjen e buxhetit total edhe shpenzimet tjera janë rritur. Shpenzimet kapitale gjatë vitit 2009 kanë qenë afër 1 milion euro, që janë më të lartat

në historinë buxhetore të Obiliqit. Po ashtu edhe për rroga dhe mëditje janë paraparë si asnjëherë më parë rreth 1.8 milion euro. Në përgjithësi buxheti i vitit 2009 është pothuajse dyfishii buxhetit të vitit 2003.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€1,800,403	€239,831	€76,000	€38,500	€980,760	-	€3,135,494
2008	€1,554,903	€272,660	€73,000	€38,500	€417,641	-	€2,356,704
2007	€1,497,920	€247,695	€74,956	€28,500	€345,873	-	€2,194,944
2006	€1,489,418	€297,205	€56,900	€6,000	€384,678	-	€2,234,201
2005	€1,425,040	€239,723	€115,000	€7,527	€779,844	-	€2,567,134
2004	€1,432,513	€310,120	-		€338,586	€28,660	€2,109,879
2003	€1,003,764	€333,077	-		€320,240	€20,568	€1,677,649

Përveç ngritjes së buxhetit total, nga tabela e mësipërme mund të shohim se ka pas kryesisht edhe lëvizje në buxhetin e ndarë për rroga dhe mëditje. Në të vërtetë, nga buxheti i vitit 2009, pjesa më e madhe është ndarë për rroga dhe mëditje që ishte 1,800,403 euro.

Investimet kapitale

Gjatë dy viteve të kaluara, Komuna e Obiliqit një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të saj e ka ndarë edhe për investime kapitale. Për vitin 2009 për shpenzime kapitale ishin ndarë 980,760 euro, kurse për vitin 2008 ishin ndarë 417,641 euro. Nga buxhetet e tilla janë financuar këto projekte kapitale:

Tab.5.: Investimet kapitale në Obiliq gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Breznicë (faza e II-të)	€65,000
2008	Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza në fshatin Plemetin	€250,000
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Mazgit	€173,000
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Sibovc	€140,000
2009	Asfaltimi i rrugës Sibovc-Nicaj	€100,000
2009	Asfaltimi i rrugës Ferrid Curri	€58,852

Kuvendi Komunal i Obiliqit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Obiliqit do të ketë në dispozicion 3,179,380 euro për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Obiliqit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 4.3 milion euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Obiliqit 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	3,459,000	3,496,710	3,617,560
Të hyrat vetanake në €	479, 418	494,638	508,906
Investimet kapitale në €	994,370	1,032,080	1,152,930

Administrata komunale

Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2009 ka të punësuar 629 punonjës në arsim, shëndetësi dhe administratë. Po të krahasohet me vitin 2008, numri i stafit është rritur për 14 persona. Ndërkaq, sipas vendimit 10/49 të Qeverisë së Kosovës, që parasheh se duhet të ketë 1 shërbyes civil për 620 banorë, del se komuna e Obiliqit duhet të shtojë pjesëtarë të stafit komunal. Momentalisht, në komunë janë të punësuar 87 persona, kurse sipas vendimit të lartpërmendur komuna duhet të ketë 97 punonjës.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Obiliqit sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	629 ▲
2008	615 ▲
2007	614
2006	638 ▲
2005	617
2004	656 ▲
2003	598 ■

Komuna e Obiliqit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, kuvendi komunal duhet të mbajë të paktën 10 mbledhje. Kuvendi Komunal i Obiliqit ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje, një më pak se që paraparë me ligj. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, kuvendi komunal i kësaj komune ka mbajtur 4 mbledhje, duke mos përmbushur kështu normën e paraparë me nenin 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Kurse Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është grumbulluar gjithsej 8 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Brenda këtyre dy viteve Komuna e Obiliqit ka mbajtur edhe tubime publike me qytetarët. Gjatë vitit 2008 komuna ka mbajtur 3 tubime publike, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 është mbajtur vetëm 1 tubim. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumentat zyrtare, nuk ka ndonjë të dhënë nëse kjo komunë ka pranuar ndonjë kërkesë. Kjo komunë gjatë vitit 2008 ka pranuar gjithsej 4 peticione nga ana e qytetarëve.

Ueb faqja është e mirëmbajtur/azhurnuar relativisht mirë (azhurnimi i fundit më 25.08.2009). Ueb faqja e komunës së Obiliqit ka mungesa të konsiderueshme informacionesh të cilat do t'i nevojiteshin çdo qytetari rreth aktiviteteve të komunës siç janë, p.sh.: shërbimet komunale, të cilat mungojnë në tërësi, projektet komunale gjithashtu, pastaj në përgjithësi ueb faqja ka mangësi si në strukturën organizative ashtu edhe në mbajtje të të dhënave në ueb faqe.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit (www.komuna-obiliq.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	2
Organizimi komunal	1.67
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	2.13
Projektet komunale	1
Lajme& lajmërimë	3.67
Harta e faqes	3
Kontakt	4
Gjuhët	2
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	2.20
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	24

Gjendja në arsim

Sistemi i arsimit në Komunën e Obiliqit është i organizuar në atë parashkollor, fillor dhe të mesëm. Obiliqi ka vetëm një çerdhe ku janë të sistemuar 43 fëmijë. Bashkë me paralelet e ndara, Obiliqi ka 17 shkolla fillore, ku në 4 prej tyre vijojnë mësimin nxënësit serb. Numri i nxënësve në shkollat fillore është 4,411 nxënës. Kjo komunë ka dy shkolla të mesme, një në gjuhën shqipe dhe tjetra në gjuhën serbe, kurse numri i nxënësve është 1,122. Numri i mësimdhënësve në komunën e Obiliqit është 305, kurse në përgjithësi kjo komunë ka 1.5 punonjës të arsimit për 100 banorë. Në testin kombëtar të maturës 2008, maturantët e Obiliqit kanë shfaqur performancën më të dobët në Kosovë, ku vetëm 9.2% e maturantëve kanë kaluar testin e parë kurse në të dytin kanë kaluar vetëm 5.6%. Nxënësit e shkollës së mesme profesionale nuk mbajnë fare orë praktike dhe kjo shihet si pengesë e madhe në kalimin e testit të maturës. Sa i përket infrastrukturës shkollore, infrastruktura është përmirësuar dukshëm pas ndërtimit të objekteve të reja shkollore. Në nivelin e ulët të edukimit ndikon edhe mungesa e transportit publik, sidomos për banorët e vendeve rurale.

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Gjendja në shëndetësi

Në Komunën e Obiliqit përveç QKMF, ekzistojnë edhe 7 QMF tjera. Numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësor është 103, kurse kjo komunë ka një mesatare prej 3.8 punonjës për 1,000 banorë, që është mesatare mjaft e mirë. E tërë komuna e Obiliqit posedon vetëm një autoambulancë, ku në rast se paraqiten dy raste emergjente njëkohësisht, stafi i QKMF është në dilemë se kujt më parë t’ia dërgoj autoambulancën. Për shkak të ambientit të ndotur nga termocentralet, qytetarët e Obiliqit vuajnë nga sëmundje të ndryshme të frymëmarrjes, mushkërive, etj. Drejtoria komunale për Shëndetësi nuk posedon asnjë statistikë rreth asaj se cilat sëmundje shfaqen më shpesh si pasojë e ambientit të ndotur dhe se sa është shkalla e rrezikshmërisë më e madhe se në pjesët tjera të Kosovës. Një sukses i shënuar në aspektin e shëndetësisë është se aparaturat të cilat kanë qenë donacione të huaja dhe janë blerë nga vendorët, për një kohë të gjatë kanë qenë jo funksionale dhe vetëm tani janë funksionalizuar. Në Obiliq nuk ka pulmolog (mjek të mushkërive) edhe pse sëmundjet më të mëdha në këtë komunë janë sëmundje të mushkërive. Po ashtu nuk ka as onkolog, as internist, as biokimist. Të gjitha këto shërbime janë me interes për specifikat e komunës së Obiliqit dhe për sëmundjet që paraqiten si rezultat i ambientit të papastër.

Shoqëria civile

Në Obiliq funksionojnë disa organizata jo qeveritare, fokusi kryesor i të cilave është mbrojtja e ambientit, si janë: “Miq të tokës”, Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit, “Aureola”, etj. OJQ “Aureola” ka qenë njëra ndër organizatat më aktive në këtë komunë, fokusi kryesor i së cilës ka qenë mbrojtja e mjedisit dhe fuqizimi i gruas. Pasi që drejtoresha e kësaj organizate është kyçur në parti politike dhe ka hequr dorë nga pozicioni i saj në OJQ, kjo organizatë është dobësuar dukshëm. Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit është organizatë tjetër aktive në Obiliq e cila ka shumë aktivitete sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Nuk ka asnjë organizatë jo qeveritare e cila merret kryesisht me monitorimin e punës së kuvendit komunal.

Mediat lokale

Radio Evropa është radio e vetme lokale që është aktive në këtë komunë, sidoqoftë kjo radio nuk bënë monitorimin e institucioneve komunale, apo transmetimin e mbledhjeve të kuvendit komunal. I vetmi korrespondent për Komunën e Obiliqit për gazetat e përditshme, ka qenë ai i të përditshmes “Bota Sot” mirëpo që 8 muaj Komuna e Obiliqit nuk ka asnjë korrespondent lajmesh.

Rendi dhe ligji në Komunën e Obiliqit

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Obiliqit kanë ndodhur 511 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 53 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Obiliq (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	93
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	20
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	14
Vjedhje e pyjeve	1
Incidente lidhur me pronën	21
Vjedhje	169
Abuzime seksuale	6
Shkaktim të dëmtimeve trupore	28
Kërcënime	13
Mashtrime	1
Vrasje	4
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

Në përgjithësi komuna e Obiliqit është treguar relativisht e qetë sa i përket shkeljes së rendit dhe qetësisë publike. Gjatë vitit 2008 janë shënuar 93 aksidente trafiku, kurse rendi dhe qetësia publike është prishur vetëm 20 herë. Megjithatë në këtë komunë është shënuar një numër i madh i vjedhjeve, ku gjatë një viti kanë ndodhur 169 raste. Është gjithashtu shqetësuese fakti se kanë ndodhur 4 vrasje gjatë vitit 2008.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlllogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Obiliqit

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.10%	0.10%	0.20%	0.25%	0.10%
I	360€	360€	520€	500€	150€
II	250€	340€	420€	400€	140€
III	-	300€	360€	300€	120€
IV	-	200€	320€	200€	100€

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në Komunën e Obiliqit janë të regjistruara rreth 278 biznese. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale. Duke u bazuar në Rregullore komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	1,000 €
Kompanitë e sigurimit	1,000 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	1,000 €
KEK	1,000 €
Hotelet	800 €
Motelet	600 €
Supermarketet-Hipermarketet	400 - 500 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	200 €
Kafeteritë	150 €
Barnatoret	300-500 €
Gurthyesit	2,000 €
Autoshkollat	150 €
Nxerrja dhe përpunimi i qymyrit	20,000 €
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike	15,000 €
Prodhimi i gazit	2,000 €
Deponitë regjionale të mbeturinave	10,000 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	70-100 €
Punimet e përgjithshme mekanike	2,000 €
Agjensionet turisitike	300 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	200 - 300 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.